



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:180368

Datë: 02.04.2024

Numri i dokumentit: 05534316

KPPP.nr. 1556/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Xella Kosova” L.L.C., me numër unik identifikues 810593188 dhe me seli në Graçanicë, Gushtericë e Ulët, kundër debitorit “Grand Construction” Sh.P.K., me numër të unik identifikues 811052109 dhe me seli në Ferizaj, Magjistratja Ferizaj - Shkup, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Kërveshi & Partners” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 32/2020 i datës 12.03.2020, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Arben Gashi nga Prishtina, jashtë seancës me datën 02.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Grand Construction” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 32/2020 i datës 12.03.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Arben Gashi, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Xella Kosova” L.L.C., me datë 12.03.2020 ka lëshuar urdhrin P.nr. 32/2020, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Faturës nr. INV-19-0727, e datës 03.06.2019; Faturës nr. INV-19-0728, e datës 03.06.2019; Faturës nr. INV-19-0729, e datës 03.06.2019; Faturës nr. INV-19-0730, e datës 03.06.2019; Faturës nr. INV-19-0801, e datës 14.06.2019; Faturës nr. INV-19-0819, e datës 17.06.2019; Faturës nr. INV-19-0866, e datës 24.06.2019; Faturës nr. INV-19-0915, e datës 01.07.2019, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që pas pranimit të urdhrin në emër të borxhit të përcaktuar sipas

faturave të lartcekura t'ia paguaj kreditorit shumën prej 3,768.62 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbarimor me arsyetim se dokumenti në bazë të së cilit është marrë urdhri përmbarimor nuk ka titull ekzekutiv apo tipare të përmbarueshmërisë. Më tej, ka theksuar se në propozimin për përmbarim janë shënuar faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri përmbarimor, ashtu që për faturën nr. INV-19-0727 është shënuar vlera 28.32 €, mirëpo një vlerë e tillë nuk përkon me vlerën reale të faturës së bashkangjitur në propozimin për përmbarim, ndërsa për faturat tjera nuk është cekur vlera e tyre. Ka shtuar se kërkesa e kreditorit është parashkruar pasi që ka kaluar afati ligjor për të kërkuar pagesën e detyrimit të pretenduar, për faktin që faturat janë lëshuar për periudhën prej muajit qershor 2019 deri në muajin korrik 2019, ndërsa debitori ka pranuar urdhrin përmbarimor me datë 11 gusht 2022, që do të thotë se afati prej 3 viteve është tejkaluar, gjë që e bën kërkesën e kreditorit të parashkruar sipas nenit 353, par. 1 të LMD-së. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës të që aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet, si dhe të obligohet kreditori që të paguajë shpenzimet e procedurës përmbarimore në shumë prej 104.00 €, sipas tarifës së OAK-së.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetim se sa i përket pretendimit të debitorit se vlera e kërkuar për përmbarim në lartësi prej 28.32 € në faturën nr. INV-19-0727 nuk korrespondon me vlerën e faturës, një pretendim i tillë qëndron, mirëpo nuk ka asnjë relevancë për vlefshmërinë e urdhrin përmbarimor për arsye se debitori e ka paguar një pjesë të borxhit nga fatura, andaj ka kërkuar vetëm pjesën e mbetur të borxhit nga ajo faturë. Edhe sa i përket pretendimit se nuk janë shënuar shumat për secilën faturë, por vetëm borxhi total nga faturat, debitori megjithatë nuk e konteston lartësinë e borxhit por formën e propozimit për përmbarim, pa i'u referuar ndonjë dispozite ligjore për formën. Më tej, ka theksuar se debitori në prapësim ka pretenduar se kërkesa është parashkruar sipas nenit 353 të LMD-së, mirëpo një pretendim i tillë nuk qëndron për faktin se ky nen ka të bëjë me kërkesat periodike, ndërsa në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesa reciproke nga kontratat komerciale, ashtu që parashkrimi i kërkesave është 3 vite, siç përcaktohet me nenin 355 të LMD-së. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa debitori të obligohet që të paguajë shpenzimet procedurale.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që

gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. INV-19-0727, e datës 03.06.2019; Fatura nr. INV-19-0728, e datës 03.06.2019; Fatura nr. INV-19-0729, e datës 03.06.2019; Fatura nr. INV-19-0730, e datës 03.06.2019; Fatura nr. INV-19-0801, e datës 14.06.2019; Fatura nr. INV-19-0819, e datës 17.06.2019; Fatura nr. INV-19-0866, e datës 24.06.2019; Fatura nr. INV-19-0915, e datës 01.07.2019, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, gjykata konstatoi se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit e pasqyruar në secilën faturë, dhe të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përbarimit pasi që janë të përshtatshme për përbarim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se në propozimin për përbarim janë përshkruar faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri përbarimor, mirëpo nuk është cekur vlera e secilës faturë veç e veç, por që në rastin konkret, shuma totale e borxhit të kërkuar nga kreditori me propozimin për përbarim, është në kuadër të shumës totale të faturave të cilat i janë bashkangjitur propozimit, andaj propozimi për përbarim, nuk tejkalon kufijtë e përbarimit të përcaktuar me dokumentet mbi bazën e të cilave është lejuar përbarimi.

Gjykata pati parasysh edhe pretendimin e debitorit se në rastin konkret borxhi është parashkruar por që nga shkresat e lëndës, rezulton se faturat e bashkangjitura në propozimin për përmbarim janë bërë të arritshme përgjatë viti 2019, ndërsa propozimi për përmbarim është dorëzuar tek përmbaruesi privat me datë 11.03.2020, pra pa kaluar afati i parashkrimit i përcaktuar me nenin 355.1 të LMD-së i cili parasheh se “1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite”, ndërsa data e pranimit të urdhrit përmbarimor nga ana e debitorit, nuk përcaktohet si fakt për llogaritjen e afateve të parashkrimit dhe ndërprerjes së tij.

Gjykata pati parasysh edhe pretendimet tjera të ngritura nga debitori në prapësim, por gjeti i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë siç kërkohet me neni 69 par.4 të LPP-së, për të vërtetuar ekzistimin e një prej shkaqeve të parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1556/23, datë 02.04.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.